



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1429/3 prot.

Tiranë, më 02. 12. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 290, datë 02. 12. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 217, datë 28.10.2024, të paraqitur nga G. G., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, me pretendimin për diskriminim *për shkak të bindjeve politike dhe çdo shkak tjetër*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon ndër të tjera se, është nëpunës i administratës Tatimore në Drejtorinë Rajonale Berat, prej datës 10.02.2000, ku është emëruar në pozicionin e Inspektorit.

Mbështetur në informacionin bashkëngjitur ankesës, nga momenti i emërimit në strukturat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, ankuesi në vijim ka mbajtur detyrat si më poshtë:

- në datën 26.12.2006, është emëruar në detyrën e Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit;
- në datë 15.05.2009, është liruar nga detyra e Përgjegjësit në Sektorin e Operacioneve të Kontrollit në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor Berat dhe është emëruar përkohësisht në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DRT Berat;
- në datën 27.07.2011 është liruar nga detyra e Drejtorit në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DRT Berat dhe është emëruar përkohësisht Drejtor i DRT Berat, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune;
- në datë 21.02.2013 është emëruar përkohësisht në pozicionin e Drejtorit të DRT Berat, deri në përfundim procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune;

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

- në datën 23.04.2013 është liruar nga detyra e Drejtorit të DRT Berat, detyrë të cilën e mbante përkohësisht dhe është emëruar po përkohësisht në detyrën e Përgjegjës në Sektorin e Përpunimit të Deklaratave, Vlerësimit dhe Rimbursimit në DRT Berat, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune;
- në datë 20.01.2014 është liruar nga detyra e Përgjegjës në Sektorin e Përpunimit të Deklaratave, Vlerësimit dhe Rimbursimit pranë DRT Berat, detyrë të cilën e mbante përkohësisht dhe është emëruar në detyrën e Drejtonit të Drejtorisë së Kontrollit në DRT Berat;
- me shkresën “*Akti i Deklarimit të Statusit të Punësimit*” Nr. 1603/117 Prot., datë 30.10.2014, të DAP, është konfirmuar si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit në DRT Berat;
- në datën 05.11.2015, i ka përfunduar delegimi i kompetencave të Drejtorit Rajonal në DRT Berat dhe është rikthyer në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, të cilin e ka mbajtur deri më datë 27.07.2022, kur është transferuar përkohësisht si Përgjegjës Sektori në Sektorin e Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara-Rajoni Jugor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier;

Në në muajin maj 2022, Departamenti i Administratës Publike (DAP), kishte shpallur thirrjen “*nr. 4109 “Shpallje për lëvizje paralele; Ngritje në detyrë; Pranim nga jashtë shërbimit civil; Në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese”, “ Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat - kategoria: III-a”*”.

Referuar kritereve të shpallura nga DAP-i, ankuesi dhe kandidatë të tjerë, kishin konkurruar në procedurën për ngritje në detyrë dhe nuk ishte shpallur asnjë prej tyre fitues.

Në vijim ankuesi ka konkurruar në procedurën për pranim nga jashtë shërbimit civil. Në këtë procedurë konkurrimi ka marrë pjesë ai dhe D. K. Në përfundim, në muajin korrik 2022, është shpallur fituese për pozicionin e mësipërm, nga jashtë shërbimit civil D. K.

Pas emërimit, të D. K., në datë 27.07.2022, ankuesi është transferuar përkohësisht në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara-Rajoni Jugor.

Me shkresën nr. 1374/2 prot., datë 23.08.2022, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat është propozuar që ndaj ankuesit të nisë ecuria disiplinore. Në përfundim të shqyrtimit, më datë 03.11.2022, Komisioni i Disiplinës ka vendosur: “*Marrjen e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 2 vjeçare”*”.

Më datë 31.03.2023, për shkak të përfundimit të periudhës së zëvendësimit për shkak të ligjit, ankuesi është rikthyer në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Berat.

Me shkresën nr. 13853/1 prot., datë 12.09.2023, ankuesi është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Bazuar në sa më sipër, sipas ankuesit, pavarësisht se nuk ishte kryer asnjë shkelje ligjore, në datën 17.10.2023 i është përcjell Urdhri nr.

15, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, për largimin nga shërbimi civil, bazuar në Vendimin nr. 412, datë 10.10.2023 të Komisionit të Disiplinës.

Referuar veprimeve të sipërcituara, ankuesi pretendon se veprimet e njëpasnjëshme ndaj tij, nga momenti i konkurrimit për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, në maj 2022, deri në momentin final të largimit nga puna, në 17.10.2023, kanë patur si qëllim diskriminimin e tij, bazuar në bindjet e politike të mëparshme, si anëtarë dhe kandidat për Kryetar të Komunës Vertop, në zgjedhjet vendore të vitit 2011, për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Subjekti ankues pretendimet e tij për diskriminim nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, lidhur me largimin nga detyra dhe zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës, i ngre në kuadër të “bindjeve politike” dhe “çdo shkak tjetër”, duke referuar tek ky shkak, prej faktit se drejtuesja e re që u emërua në detyrë nuk kishte dëshirë që unë të vazhdoja të punoja në institucionin që kisha drejtuar më parë dhe që në vijim do të drejtohej prej saj, duke i lidhur ato me dy momente kryesore:

Së pari, për shkak se në zgjedhjet vendore të vitit 2011, ankuesi ka kandiduar si përfaqësues i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për pozicionin e Kryetarit të Komunës Vertop.

Së dyti, për shkak se sapo drejtuesja e re është emëruar në detyrën e Drejtorit Rajonal të Tatimeve Berat, ndaj tij janë marrë masat, fillimisht të transferimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, e më pas është larguar nga detyra.

- *Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ....b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; .....ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;” Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:*

➤ *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të bindjeve politike, duke referuar se në zgjedhjet vendore të vitit 2011, ka kandiduar si përfaqësues i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për pozicionin e Kryetarit të Komunës Vertop.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon

*barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëritjetri<sup>3</sup>. GJEDNJ, në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Sipas LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma (neni 3, LMD), ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2 LMD) ose në formën e “Diskriminimit të tërthortë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7, LMD).

Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përliqur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përliqur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislati në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje

<sup>3</sup> Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të Tjerët kundër Rusisë, prg. 90.

nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Referuar parashtrimeve të bëra në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi pretendon se, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat kanë kryer një sërë veprimesh të parregullta të cilat kanë patur si qëllim largimin e tij nga puna, për shkak të bindjeve të tij politike që lidhen me momentin e kandidimit të tij në zgjedhjet vendore të vitit 2011, si përfaqësues i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për pozicionin e Kryetarit të Komunitetit Vertop.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person pretendon një shkak të mbrojtur, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, ankuesi nga momenti i kandidimit të tij në zgjedhjet vendore të vitit 2011, si përfaqësues i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, për pozicionin e Kryetarit të Komunitetit Vertop, nuk ka patur asnjë aktivitet politik të njohur apo të bërë publik. Lidhur me bindjet politike ai referon vetëm momentin që ka kandiduar në zgjedhjet vendore të vitit 2011. Gjithashtu, nga provat dhe informacioni i administruar, rezulton se ankuesi pavarësisht transferimit të tij apo emërimit të përkohshëm në detyra të tjera (sipërcituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi), që nga viti 2011, kur ka kandiduar në zgjedhjet vendore, ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore apo veprime të cilat justifikojnë trajtimin e padrejtë a të pafavorshëm të pretenduar prej tij. Ankuesi deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit, më datë 17.10.2023, ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Berat. Pra, që nga viti 2011 e në vazhdim, nuk shihet të ketë pasur ndaj ankuesit veprime apo mosveprime, përmes së cilave mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në lidhje me provueshmërinë e shkakut të pretenduar “bindjet politike”, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk paraqiti fakte dhe prova për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ana e tij.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se shkak i pretenduar i diskriminimit “bindjet politike”, pavarësisht se është një shkak që gëzon mbrojtje sipas LMD, bazuar në faktet dhe rrethanat dhe provat e administruara nuk rezultojnë të provuar.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, duke referuar tek ky shkak pretendimin se sapo drejtuesja e re është emëruar në detyrën e Drejtorit Rajonal të Tatimeve Berat, ndaj tij janë marrë masat, fillimisht të transferimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, e më pas është larguar nga detyra.*

Komisioneri, (njëlloj si për rastin e provueshmërisë së shkakut të pretenduar nga ankuesi lidhur me bindjet politike), edhe në këtë rast, në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë, nuk është paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale, por referon si shkak faktin që *sapo drejtuesja e re është emëruar në detyrën e Drejtorit Rajonal të Tatimeve Berat, ndaj tij janë marrë masat, fillimisht të transferimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, e më pas është larguar nga detyra.* Sakaq, këto pretendime nuk lidhen me shkakun, cilësinë e veçantë apo ndonjë karakteristikë individuale specifike të ankuesit.

Transferimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, e më pas largimi nga detyra ankuesi e lidh me momentin e emërimit të drejtueses së re në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat. Fakti i emërimit të saj në këtë pozicion, nuk është një shkak apo një argument që lidhet me cilësinë e veçantë apo ndonjë karakteristikë individuale specifike të ankuesit.

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që subjekti ka paraqitur, nuk ka dhënë asnjë informacion shpjegues mbi shkaqet e pretenduara të diskriminimit. Komisioneri, vlerëson se, vetëm fakti që ankuesi ka cituar ato nuk provon në vetvete posedimin e tyre.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i subjektit ankues për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe “çdo shkak tjetër”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezultojnë të provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

Pala ankuese nuk parashton e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkaqet e pretenduara, mbi të cilat të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse G. G. është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga bindjet politike, dhe “çdo shkak tjetër”.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: .....ç) .....nuk ka informacion të

*mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.*

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, G. G., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar<sup>4</sup>.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet politike)  
(Fusha: Punësim)

---

<sup>4</sup> Për analogji, nga praktika e KMD-së, citojmë: Vendimin nr. 81/2022, Vendimin nr. 117/2022, Vendimin nr. 51/2023.